

Titulli i lëndës: Infermiera Geriatrike dhe Gerontologjia

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë
Titulli i lëndës:	Infermiera Geriatrike dhe Gerontologjia
Niveli:	BSc Infermieri
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I, Semestri i dytë
Numri i orëve në javë:	45 (L) + 15 (S) + 30 (PL) + 45 (PK)
Kreditë - ECTS:	6 ECTS
Koha/Vendi:	Sipas orarit. IKSHPK
Mësimdhënësi:	Prof. Assoc. Naim Jerliu
Të dhënat kontaktuese;	naim.jerliu@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kjo lëndë i prezenton studentit konceptet kryesore të moshës dhe moshimit (plakjes), tendencat demografike në botë dhe në vendin tonë, bazat e gerontologjisë dhe geriatriisë, si dhe konceptet bazë të infermierisë gerontologjike. Diskutohen nevojat fiziologjike, sociale dhe psikologjike të të moshuarve në lidhje me rolin e infermierisë gerontologjike. Theksi vihet në kuptimin e nevojave unike të personit të moshuar, identifikimin e përgjigjeve të ndryshueshme të të moshuarve ndaj kushteve patologjike dhe mbajtjen e një niveli funksionimi që promovon cilësinë e jetës dhe inkurajimin e promovimit të shëndetit dhe vetëkujdesit. Mbi të gjitha theksohet rëndësia e kujdesit të individualizuar dhe holistik për të moshuarin.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimet e lëndës janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të sigurojë një përvojë arsimore e cila do të zhvillojë aftësitë e studentit në mënyrë që të lehtësojë zhvillimin e aftësive të gjykimit të pavarur dhe zgjidhjes së problemeve në lidhje me kujdesin për të moshuarit; • të sigurojë një kuadër edukativ që do të inkurajojë studentin të zhvillojë aftësitë e saj/tij të analizës dhe ndërgjegjësimit kritik në mënyrë që të stimulojë një qasje kërkuese dhe krijuese si për teorinë ashtu edhe për praktikën e infermierisë gerontologjike;

	<ul style="list-style-type: none"> • të zhvillojë aftësinë e studentit për t'iu përgjigjur nevojave në ndryshim në infermierinë gerontologjike në mënyrë analitike.
<p>Rezultatet e pritshme të nxënies:</p>	<p>Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studenti do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • njihet me trendet demografike në Kosovë dhe në botë, • kuptojë aspekte të ndryshme të moshimit (plakjes) dhe teoritë e moshimit (plakjes) • njohë ndryshimet dhe nevojat normale fiziologjike, psikosociale dhe shpirtërore të të moshuarve për shkak të moshimit (plakjes) • prioritizojë nevojat fiziologjike, psikosociale dhe shpirtërore kur kujdeset për të moshuarit • përdorë procesin infermior dhe aftësitë e të menduarit kritik për të zhvilluar një plan kujdesi për problemet e zakonshme fiziologjike, psikosociale dhe shpirtërore të të moshuarve, • njohë dhe kuptojë ndryshimin midis kujdesit gerontologjik dhe geriatrik, • përmbushë detyrat në kontekstin e ofruesve të kujdesit infermior, kujdesit infermior geriatrik ose të integruar të të moshuarve, • zotërojë zbatimin themelor të kujdesit infermior për të moshuarit me sëmundje të ndryshme kronike, • kuptojë parimet e administrimit të barnave tek të moshuarit për të administruar në mënyrë të sigurt medikamentet dhe monitorimin e pacientëve për reaksione anësore, • kuptojë rolin dhe detyrat e kujdesit për të moshuarit me nevoja të veçanta si rezultat i situatës së përgjithshme, natyrës së sëmundjes, simptomave, trajtimit, • fitojë aftësi në kujdesin infermior të të moshuarve me demencë dhe të mund të përfshihet në kujdesin e të moshuarve me demencë,

	<ul style="list-style-type: none"> • identifikojë teknikat e komunikimit terapeutik kur punon me të moshuarit, • përshkruajë parimet e sigurisë kur punon me të moshuar duke përfshirë rrëzimet, kufizimet, çështjet mjedisore dhe demencën, • përshkruajë aspektet etike dhe ligjore të përfshira në ofrimin e kujdesit për të moshuarit • njohë rëndësinë e bashkëpunimit me profesionistët tjerë, familjen dhe personat tjerë të rëndësishëm, • njohë format e ndryshme të mbrojtjes për të moshuarit, • kuptojë rëndësinë e një qasjeje të integruar për trajtimin e të moshuarve, • kupton dhe njehë vështrimin e përgjithshëm të shqetësimit për moshimin cilësor dhe cilësinë e jetës së të moshuarve, • marrë parasysh zhvillimin e strategjisë për mbrojtjen e të moshuarve, të drejtat e të moshuarve dhe dokumentet themelore.
--	---

Ngarkesa e punës së studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies të studentit			
<i>(orët/semestri, ECTS):</i>			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime praktike/punë në laborator	2	15	30
Punë praktike/praktikë klinike	3	15	45
Konsultime me mësimdhënësin			
Puna në terren			
Praktikë seminarike/Kolokiume	1	15	15
Detyrë shtëpie			
Mësim individual (në bibliotekë ose shtëpi)			15
Përgatitja për provim final			
Koha e vlerësimit (teste, kuiz, provimi final)			4
Projekte, prezantime etj.			1
Total			155 /6 ECTS

Metodat e mësimdhënies:	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Ligjërata</i> me pjesëmarrje aktive të studentëve (shpjegim, diskutim, pyetje, shembuj, zgjidhje problemesh); • <i>Tutorial</i>: përgatitja, prezantimi dhe mbrojtja e suksesshme e një punimi seminarik (zgjidhja e problemit - MBP, rastet studimore me diskutim, metodat e të menduarit kritik, pasqyrimi i përvojës, vlerësimi, puna me projekte, puna ekipore). • <i>Ushtrim praktik/laboratorik</i>: zbatimi i njohurive të marra në mjedisin laboratorik/simulues. • <i>Praktika klinike</i>: aplikimi i njohurive të marra në mjedisin klinik.
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Vijueshmëria dhe pjesëmarrja/aktiviteti në klasë: 10% • Përgatitja, prezantimi dhe mbrojtja e punimit seminarik: 20% • Provimi përfundimtar: 70% • Gjithsej: 100%
Literatura	
Literatura primare:	<ul style="list-style-type: none"> • Patricia A. Tabloski. Gerontological Nursing. The Essential Guide to Clinical Practice (4th Ed.), Pearson, 2018 • Charlotte Eliopoulos. Gerontological nursing (9th Ed.), Wolters Kluwer, 2018 • Wiliams, P. Basic geriatric nursing. St. Louis: Elsevier, 2016 • Naim Jerliu. Kujdesi ndaj pacientëve të moshuar. <i>Aspekte të menaxhimit të sëmundjeve kronike dhe të komunikimit me pacientët e moshuar</i>. AQH, Prishtinë, 2019 • <i>Kujdesi Mjekësor për të Moshuarit (Përmbledhje materialesh/manual për studentë – për përdorim të brendshëm)</i>, Prishtinë, 2022
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> • David Sinclair, Matthew D. LaPlante (2019). <i>Lifespan: Why We Age - and Why We Don't Have To</i>. Atria Books. • Kristen L. Mauk. Gerontological Nursing: Competencies for Care. Jones & Bartlett Learning, LLC, 2013 • Buttaro, T. M, Kate A. Barba, A.K. (2013). Nursing care of the hospitalized older patient. Chichester: Wiley-Blackwell.

	<ul style="list-style-type: none"> • Meredith Wallace Kazer, Leslie Neal-Boylan. Case Studies in Gerontological Nursing for the Advanced Practice Nurse. Wiley Blackwell. 2012 • Jerliu N, Burazeri G, Toçi E, Philp I, Czabanowska K, Ramadani N, Brand H. Application of EASY-Care Standard 2010 instrument in a population-based survey in transitional Kosovo. Eur J Public Health. 2018 Aug 31. • Jerliu N, Burazeri G, Toci E, Kempen GIJM, Jongen W, Ramadani N, Brand H. Social networks, social participation and self-perceived health among older people in transitional Kosovo. Eur J Public Health (2014) 24 (2):333-337. • Jerliu N, Toçi E, Burazeri G, Ramadani N, Brand H. Prevalence and socioeconomic correlates of chronic morbidity among elderly people in Kosovo: a population-based survey. BMC Geriatrics 2013; • Jerliu N, Toçi E, Burazeri G, Ramadani N, Brand H. Socioeconomic conditions of elderly people in Kosovo: a cross-sectional study. BMC Public Health 2012, 12:512
--	--

Plani i detajuar mësimor

Java	Tema/Titulli
Java e parë:	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Prezentim i lëndës</i> • <i>Mosha dhe moshimi (plakja), moshimi përgjatë historisë në botë, Evropë dhe Kosovë.</i> • <i>Gerontologjia, geriatra, tendencat demografike, ndikimi social dhe këndvështrimi mbi moshën, moshimin dhe të moshuarit.</i>
Java e dytë:	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Gerontologjia dhe kujdesi infermieror gerontologjik. Parimet e gerontologjisë.</i> • <i>Teoritë e moshimit (plakjes)</i> • <i>Ndryshimet e moshimit.</i>
Java e tretë:	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Geriatra dhe infermiera geriatrike. Parimet e geriatrisë.</i> • <i>Vlerësimi geriatrik. Komponentët e vlerësimit gjithëpërfshirës geriatrik.</i> • <i>Mjetet dhe instrumentet për vlerësimin geriatrik</i>
Java e katërt:	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Të ushqyerit dhe moshimi (plakja). Shqetësimet e zakonshme të nutricionit tek personat e moshuar.</i>
Java e pestë:	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Farmakologjia dhe të moshuarit. Efektet e medikamenteve dhe parimet e administrimit të medikamenteve tek të moshuarit</i>
Java e gjashtë:	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Funksioni psikologjik dhe njohës</i>

	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Gjumi dhe të moshuarit</i>
Java e shtatë:	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Menaxhimi i dhimbjes</i>
Java e tetë:	<ul style="list-style-type: none"> • <i>"Gjiganët gjeriatrikë" modernë.</i> Sindroma e dobësisë/plogështisë (frailty), sarkopenia, anoreksia e plakjes, dëmtimi kognitiv. Rrëzimet, frakturat e ijeve, depresioni, deliriumi. Kujdesi për të moshuarit me komorbiditete.
Java e nëntë:	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Kujdesi për të moshuarit me sëmundje/gjendje kronike.</i> Menaxhimi dhe vetë-menaxhimi i sëmundjeve kronike tek pacientët e moshuar. Gjendjet (sëmundjet) kronike më të zakonshme të të moshuarve (diabeti, hipertensioni, sëmundjet kardiovaskulare, artriti,...).
Java e dhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Kujdesi infermieror i të moshuarve me nevoja të veçanta.</i> Inkontinenca, ulçera e presionit, kolonizimi i baktereve rezistente, medikamentet qetësuese, administrimi i medikamenteve, etj.
Java e njëmbëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Kujdesi shëndetësor i të moshuarve me demencë</i>
Java e dymbëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Aspektet etike dhe ligjore të përfshira në ofrimin e kujdesit për të moshuarit.</i> • <i>Kujdesi në fund të jetës</i>
Java e trembëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Komunikimi me pacientët e moshuar.</i> Teknikat e komunikimit terapeutik kur punoni me të moshuarit
Java e katërbëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Specifikat e trajtimit të të moshuarve në një mjedis rezidencial dhe brenda institucionit.</i> • <i>Kujdesi afatgjatë dhe kujdesi infermieror.</i> • <i>Kujdesi infermieror i integruar dhe kujdesi për të moshuarit.</i>
Java e pesëmbëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Moshimi i shëndetshëm.</i> Promovimi dhe mbrojtja e shëndetit të të moshuarve. • <i>Cilësia e jetës dhe moshimi.</i> Nevojat dhe risqet e të moshuarve. • <i>Strategjitë e zhvillimit të mbrojtjes së të moshuarve në botë dhe në Kosovë.</i> Dokumentet bazë, mbrojtja e të drejtave të të moshuarve, zhvillimi dhe format e shërbimeve mbrojtëse të të moshuarve, organizatave dhe shërbimeve.

Politikat akademike dhe Kodi i sjelljes:

Celularët/telefonat inteligjentë dhe pajisjet e tjera elektronike (p.sh. iPods) duhet të jenë të fikur (ose në vibrim) dhe të mos shikohen gjatë orës së mësimet.
Laptopët dhe tabletët lejohen vetëm për përdorim të heshtur; aktivitete të tjera si kontrollimi i postës elektronike personale ose shfletimi në internet janë të ndaluara.